



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

**MODALITETET PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË PROGRAMIN E  
STUDIMIT DOKTORATË NË “SHKENCAT MJEKËSORE TEKNIKE”  
VITI AKADEMIK 2023-2024**

Program i studimit të doktoratës në “Shkenca Mjekësore Teknike” përfshihet në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor në Shkenca Mjekësore Teknike”. Programi i doktoratës synon të nxisë kërkimin shkencor, duke u orientuar drejt thellimit, rikonceptimit dhe riintegritit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor.

Për të kryer regjistrimin në programin e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- te ketë përfunduar studimet e larta në shkencat mjekësore teknike dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente”;
- të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Përrjashtohen nga plotësimi i kriterit të notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit;
- të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht*, në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar (pika 3) sipas Udhëzimit Nr. 10, datë 16.06.2023 të MAS;
- të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin profesor ose profesor i asociuar, të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit;
- të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit”, në momentin e aplikimit;
- të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët e që zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”;
- të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

- të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kërkesa me propozimin e kandidatit përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- curriculum vitae;
- kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- çertifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/ pasaportës;
- dy rekomandime nga persona me titullin Profesor ose Profesor i Asociuar;
- dëshmi të gjuhës së huaj, në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar (pika 3) sipas Udhëzimit Nr. 10, datë 16.06.2023 të MAS;
- dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore, eksperiencia akademike;
- deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
- projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen qëllimi dhe objektivat, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi. Projekt propozimi duhet të jetë në përputhje me projektin kërkimor zhvillimor “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit”, të aksesueshëm në:

<https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike/njoftime/1385-projekti-rritja-e-kapaciteteve-kerkimore-shkencore-te-profesioneve-mjekesore-teknike-ne-qarkun-e-elbasanit>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

- vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar;
- mandat pagese për tarifën e aplikimit, mund të gjendet në:  
<https://uniel.edu.al/zona-e-sherbimeve>
- vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.

*Aplikanti, duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërkëkuar, me rrugë postare, për periudhën 01.02.2024 – 23.02.2024 në adresën:*

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Aplikim për doktoraturë:  
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike  
Elbasan**